



KËSHILLI DREJTUES

**V E N D I M**

**Nr. 02, datë 24.01.2019**

**Mbi rinovimin e kontratës me bankat agjente të përzgjedhura  
në listën paraprake për procesin e kompensimit**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 42, pika 7 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 25, pika 2, pika 4 dhe pika 5 të Rregullores “Për kompensimin e depozitave të siguruar”, të miratuar me Urdhër të Guvernatorit nr. 3762, datë 18.07.2016, si dhe vendimit të Këshillit Drejtues nr. 23, datë 3.10.2017 “Mbi përzgjedhjen e bankave agjente në listën paraprake për kryerjen e procesit të kompensimit”, me propozim të Komisionit të Përhershëm të Vlerësimit, Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave

---

**V E N D O S I:**

1. Të rinovojë për një periudhë 1 (një) vjeçare kontratën me bankat agjente të përzgjedhura në listën paraprake për kryerjen e procesit të kompensimit, si vijon:
  - Banka Kombëtare Tregtare SHA;
  - Banka Raiffeisen SHA;
  - Banka Intesa SanPaolo SHA.
2. Autorizohet Drejtori i Përgjithshëm të njoftojë bankat e përzgjedhura në listën paraprake, si dhe Autoritetin Mbikëqyrës lidhur me këtë vendim.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë. Ngarkohet Sektori për Marrëdhëniet me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

**Sekretar**

Donald Duraj

**Kryetar**